

Drejtuar:

Zyrës për Doktoraturë te Universitetit të Tetovës

Këshillit mësimor-shkencor të Fakultetit Filozofik

Këshilli mësimor-shkencor i Fakultetit Filozofik të Universitetit të Tetovës në mbledhjen, e mbajtur më **25.06.2020** solli Vendim për formimin e Komisionit për vlerësimin shkencor dhe profesional e dorëshkrimit të temës së doktoraturës me titull: **“Roli i “Vatrës”, dhe përfaqësuesit të saj Fan. S. Noli në revolucionin e qershorit dhe qeverisjen gjashtë mujore të vitit 1924”** të kandidatit **Mr. Naim Seferi**.

Në bazë të vendimit **16-397/2** të datës **25.06.2020**, Komision i përbërë nga: **Prof. dr. Fehari Ramadani** (kryetar), **Prof.dr. Zeqirja Idrizi**, **Prof.dr. Zeqirja Rexhepi**, **Prof.dr. Nuri Bexheti** (anëtarë) dhe **Prof.dr. Qani Nesimi** (mentor), pasi lexoi materialin në dorëshkrim, Këshillit mësimor-shkencor të Fakultetit Filozofik të Universitetit të Tetovës, i paraqet këtë:

REFERAT

Të dhëna biografike për kandidatin

Kandidati **Mr. Naim Seferi**, ka lindur më 07 nëntor 1972 në Mitrovicë. Shkollën fillore e përfundoi në shkollën fillore “Jusuf Rexha”, në fshatin Koshtovë e Bobit, Komuna e Mitrovicës. Shkollën e mesme e përfundoi në Gjimnazin “Frang Bardhi”, në Mitrovicë. Në Fakultetin Filozofik dega: Histori përfundoi studimet në vitin 2001 në Prishtinë me temën: *Popujt e Ballkanit në Kongres të Berlinit*. Në Prishtinë në vitin 2006 ka regjistruar studimet postdiplomike në Histori moderne, në vitin 2010 përfundoi studimet me temë: *Kontributi kombëtar i Federatës Panshqiptare “Vatra” në Konferencën e Paqes në Paris*. Në vitin 2002 është punësuar në Gjimnazin “Frang Bardhi” në Mitrovicë, në vitin 2004 kaloi në shkollën fillore “Jusuf Rexha” në Koshtovë ku punon edhe sot.

Informacione lidhur me lënden e punimit

Kjo temë disertacioni është marrë në studim për arsye se historiografia shqiptare por edhe ajo botërore e kanë paraqitur shumë pak të vërteten historike të argumentuar në mënyrë shkencore. Periudhen që e kam trajtuar, shumë autorë e paraqesin me ngjyrimetë gabuara politikedhe sipas interesave të shteteve tëtyre, disa të tjerë për shkak të mungesës së informatave dhe argumenteve shkencore kanë ra pre e propagandes, duke i ikur të vërtetes shkencore.

Tema e marrë në studim nga autori është bërë për arsye të vakumit shkencor historik të kësaj periudhe kur ka ndodhur revolucioni i qershorit i vitit 1924 dhe qeverisja gjashtë mujore. Edhe si revolucion është paraqitur në mënyrë të parcializuar. Shqiptarët që gjendëshin në SHBA iu bashkue rreth Federatës Panshqiptare “Vatra”, me qëllim që ta shpëtonin Shqipërinë nga shpërbërja. Çka është më e padrejtë që ka bërë historiografia e sotme është sepse e kanë paraqitur Nolin jo si antarë të Vatrës, por me lloj lloj emërtimeve politike. Shumë autor dhe historian kanë ra pre e propagandës së kohës dhe e propagandës antishqiptare duke e shkëputur Nolin nga Vatra dhe duke e lidhur me ideologji të ndryshme të cilat ishin kryekput kundër interesave të popullit shqipëtar.

Kjo temë e marrë në studim për të nxjerrë në dritë fakte dhe argumente të reja për historinë bashkohore shqiptare, në këtë temë disertacioni shihet se sa mundë të arrijë një organizatë në të mirën e popullit të vetë, në një shtet të huaj kur është e organizuar dhe funksionon si duhet. Federata Panshqiptare “Vatra”, e dërgoi Nolin si përfaqësues të saj. Kur e sheh se interesi kombëtar po rrezikohej Noli del nga parlamenti dhe formon Partinë Liberale në shtator të vitit 1923 duke e ndihmuar pluralizmin politik i cili pothuajse nuk ekzistonte në Shqipëri. Noli arriti që ti bashkoi të gjithë patriotët e asaj kohe dhe ta merrte pushtetin me forcën e armëve. Noli me patriotët shqiptarë të asaj kohe siç ishin Bajram Curri, Luigj Gurakuqi, Aqif Elbasani, Hasan Prishtin, Regjep Shala, Kasem Qafëzezi e shumë të tjerë kishin fituar kundër Zogut dhe përkrahësve të tij. Për gjashtë muaj qeverisje, qeveria e Nolit bëri reforma të mëdha dhe u detyrua ta lëshoi pushtetin për shkak të sulmit ushtarak nga Jugosllavia dhe Greqia.

Informacione lidhur me fushën shkencore në të cilën është punuar disertacioni

Në hulumtimet rreth kësaj teme janë arritur përfundime se kjo temë është e trajtuar shumë pak në krahasim me peshën politike që ka pasur dhe sidomos kontributin që ka dhanë Fan.S.Noli si përfaqësues i Federates Panshqiptare “Vatra”, në revolucionin e qershorit dhe qeverisjen gjashtë mujore të vitit 1924. Noli përveç në fushën politike rol të madhë ka dhënë edhe në fushën fetare, nëpërmes së cilës grekët dhe serbët përpiqeshin ta manipulonin opinionin botëror. Federata “Vatra”, është aktive dhe funksionon në SHBA edhe sot. Për këtë periudhë të cilën e kam trajtuar ka pasur vetëm shkrime në mënyrë të fragmentuar ku shumica e autorve nuk i kanë as nga një faqe të shkruar. Disa autor kanë paraqitur vetëm sekuenca të caktuara si p.sh fjalimi i Nolit në lidhjen e kombeve apo lufta diplomatike e Nolit për ta mbrojtur Shën-Naumin, Kelmendin dhe Vermoshin.

Përshkrimi i shkurtër i metodave të përdorura gjatë shkrimit të disertacionit

Gjithmonë duke iu përmbajtur udhëzimeve dhe rregullave të metodologjisë kërkimore-shkencore dhe teorisë së shkencës dhe historisë. Shkrimi i disertacionit është bërë ngadalë dhe me kujdes, pasi që gjatë leximit duke i përdorur metodat e shkrimit shkencor, kam arritur në përfundime shkencore dhe të gjetura me rëndësi. Kandidati është përpjekur që çdo titulli të paraqitur në kuadër të kapitujve të japi përmbajtje me rëndësi shkencore. Metodatat që janë përdorur gjatë shkrimit të kësaj teme të disertacionit janë: metoda krahasuese, metoda analitike, metoda kronologjike, metoda përshkruese, etj. Përdorimi i metodave shkencore të shkrimit dhe të nxjerrjes së hipotezave i kanë dhënë pamje shkencore këtij punimi të disertacionit.

Përshkrim i shkurtër i rezultateve të hulumtimit

Ky punim disertacioni ka arritur shumë rezultate, sepse ka nxjerr shumë fakte të reja të pa thëna deri me sot nga historiografia shqiptare. Pas marrjes së pushtetit, Noli kishte caktuar datën e zgjedhjeve me 20 dhjetor 1924 dhe do të zgjatnin deri me 20 janar 1925, parlamenti do të mbledhej në fillim të marsit 1925. Noli kishte ardhur në pushtet me një program qeveritar prej 20 pikash nëpërmes të cilit mendonte që ta stabilizonte gjendjen e rëndë që ishte në Shqipërinë e asaj kohe. Menjëherë pasi vie në pushtet Noli përpiqet që ta siguroi njohjen nga SHBA-të, Britania e Madhe, Franca, Italia madje edhe nga Jugosllavia por që fatkeqësisht nuk arriti të siguronte njohje

Në këtë hulumtim janë paraqitur fakte të reja nga historiografia shqiptare si psh, Lidhja e përfaqësuesit të organizatës “Vatra”, Fan Noli me përfaqësuesit e shoqërisë Bashkimi dhe shoqërisë Ora e Maleve si dhe me patriotë të tjerë shqipëtar, por që gjatë qeverisjes nuk patën unitet të plotë për realizimin e planeve qeverisëse. Për ti dhënë jetë pluralizmit Fan Noli kishte formuar Partinë Liberale nëpërmes së cilës kishte konkuruar në mënyrë demokratike në skenën politike shqiptare. Pas fitores së revolucionit të qershorit të vitit 1924 Fan Noli së bashku me forcat revolucionare kishin formuar Partia Demokratike. Në këtë parti bënin pjesë të gjitha organizatat që kishin qenë pjesë e revolucionit, më vonë me presionin e Lidhjes së Kombeve e cila e akuzonte Nolin se kishte një qeveri pa parlament.

Noli i kishte hapur rrugë krijimit të partive të reja si dhe zhvillimit të pluralizmit politik ku ishin formuar edhe Partia Nacionale, Partia Radikale dhe Lëvizja Liberale, të gjitha këto parti politike kishin hartuar programe qeveritare me të cilat do të konkuronin në zgjedhjet e 20 dhjetorit 1924. Sipas burimeve arkivore lufta për pushtet do të ishte e ashpër edhe brenda kampit revolucionar sidomos pas shkuarjes së Nolit në Lidhjen e Kombeve, për të fituar sa më shumë deputet në parlamentin shqiptarë këto parti kishin marrë edhe antarë të regjimit të Zogut të cilët nuk kishin pasur pozita të larta politike.

Largimi i përfaqësuesve të qeverisë së Zogut në tri drejtime tregonte faktin se më cilat shtete kishin lidhje përfaqësuesit e tij. Ikja e Myfit Libohovës në Greqi trgon lidhjet e tij me shtetin grek, ikja e Shefqet Vërlacit në Itali poashtu trgon se për cilat shtete punonte, si dhe ikja e Zogut së bashku me Ceno Kryeziun në Jugosllavi tregonte lidhjet e tyre me shtetin Jugosllav, vlenë të ceket se Ceno Kryeziu ishte drejtpërdrejt subjekt Jugosllav. Edhe pse ishin larguar nga Shqipëria përfaqësuesit e Zogut sidomos Myfit Libohova nga Greqia kishin arritur të shtrinin ndikimin e tyre tek Lëvizja Liberale e cila vepronte kinse për një Shqipëri Liberale.

Me ndihmën e Greqisë Myfit Libohova tentonte që edhe në zgjedhjet e 20 dhjetorit të kishte njerzit e vet në parlamentin shqiptarë nëpërmes Lëvizjes Liberale. Myfit Libohova së bashku me Xhemal Arianitasi kishin dërguar një numër oficerësh në Shqipëri që ta pregadisnin opinionin për kthimin e Zogut në krye të shtetit shqiptarë si dhe ta pengonin Shoqërinë Bashkimi në realizimin e planit të konfiskimit të pronave. Zogu në anën Jugosllave së bashku me Kryeziun po bënë plane që Shqipëria të pushtohej nga Jugosllavia dhe Zogu të shpallej mbret i saj. Ceno Kryeziu kishte qëndruar vazhdimisht në kufirinshqiptarë për ta destabilizuar gjendjen në brendësi të shtetit shqiptarë, për këto veprime e kishte përkrahjen e plotë të Jugosllavisë. Pas rënies së qeverisë Nolit këta persona do të bëjnë luftë në mes tyre për ta shtie shtetin shqiptarë nën influencën e huaj, siç ishte rasti i Verlacit me Ceno Kryeziun, të cilët nuk zgjodhën mjete për ta vënë shtetin shqiptarë nën ndikimin e huaj.

Marrveshja Zogu-Pashiq e e gushtit 1924 iu kishte hapur rrugë autoriteteve jugosllave që ta hartonin planin e intervenimit ushtarak kundër Shqipërisë. Përgaditjet do të intensifikoheshin gjatë qëndrimit të Nolit në sesionin e pestë të Lidhjes së Kombeve në Gjenevë, kur Jugosllavia e pa se Shqipëria nuk do të merrte kurfarë përkrahje financiare, atëherë iu lehtësua puna që ta ndihmonte Zogun që të vie në pushtet dhe pastaj nëpërmes tij ti arrijë qëllimet e saja ekspansioniste.

Sipas burimeve britanike Jugosllavia e kishte caktuar Shkupin qendër ku do të bëheshin përgaditjet ushtarake për ta sulmuar Shqipërinë, e tërë kjo për ti ikur vëmendjes së opinionit publik jugosllav dhe atij ndërkombëtarë si dhe për të qenë më afër vendit ku pritej të ndodhnin luftimet.

Shteti Jugosllav kishte përgaditur uniformën e ushtarëve pjesmarrës të njëjtë me atë të ushtrisë shqiptare e tërë kjo për të mos tërëhjekur vëmendjen e opinionit vendor dhe ndërkombëtarë, madje shteti serb përgaditjet e sulmit ushtarak ia kishte caktuar organizatës Dora e Bardhë e tërë kjo për ta mbajtur operacionin që pritej të ndodhte nëfshhtësi të plotë dhe si një luftë në mes të shqiptarëve për pushtet. Jugosllavia i kishte angazhuar edhe shqiptarët që gjendeshin në jug të saj, duke iu premtuar se me kthimin e Zogut në krye të shtetit shqiptarë do të bëhej bashkimi i Kosovës dhe Shqipërisë.

Greqia nga ana e saj i kishte premtuar Xhemal Arianitasit 200 antarë të komitetit vorio-epirot për ta ndihmuar në destabilizimin e shtetit shqiptarë në rast se do të mbaheshin zgjedhjet e 20 dhjetorit të 1924. Greqia i kishte ofruar mbështetje në paisje luftarake shqiptarëve që pritej ta sulmonin shtetin shqiptarë dhe iu kishte premtuar se në rast mos pasjes sukses do të intervenonte ushtria greke. Në anën tjetër Italia i kishte kërkuar Nolit që ta pranonte një protektorat Italian. Jugosllavia e sidomos Serbia e cila e kontrollonte pjesën jugore të shtetit jugosllav i ndiqte udhëzimet e planit të Naçertaninës serbe për eliminimin fizik të shqiptarëve, duke lidhur marrëdhënie me familjet e njohura shqiptare në të gjitha krahinat e Shqipërisë duke iu dhënë shpërblime, para dhe armë në disa raste edhe duke e përdorur shantazhin dhe eliminimet fizike.

Kundër qeverisë së Nolit ishin përgaditur për të luftuar dy shtetet ballkanike Jugosllavia dhe Greqia duke i përfshirë edhe forcat e Zogut si ushtarak rus në shërbim të shtetit jugosllav. Të gjeturat tregojnë se sulmi ishte kryer njëkohësisht si nga Jugosllavia ashtu edhe nga Greqia me 13.XII.1924, në fillim të sulmit zakonisht kishin sulmuar trupat e pa rregullta të Zogut. Rezistencën më të madhe do ta bëjë Bajram Curri i cili kishte arritur që ta zbrapste trupat e Ceno Kryeziut, kjo kishte shkaktuar panik tek autoritetet jugosllave të cilët e kishin marrë në dorë vetë intervenimin ushtarak kundër trupave të Bajram Currit. Edhe pse u thyen trupat e Bajram Currit ai nuk u dorzue deri në vdekje. Qeveria e Nolit nuk e kishte pritur një sulm kaq masiv nga Jugosllavia dhe Greqia, ai me vonesë përpiqet të blej armë nga Italia e cila e kishte prolonguar shitjen dhe në fund e kishte anuluar.

Kontributete kryesore shkencore të kandidatit

Në këtë punim disertacioni kandidati është përpjekur që të nxjerrë sa më shumë fakte të pa thëna shkencore rreth temës, Roli i Vatrës dhe përfaqësuesit të saj Fan.S.Noli në qeverisjen gjashtë mujore të vitit 1924. Kandidati i këtij punimi ka punuar në paraqitjen e temës së marrë në studim me fakte dhe argumente historike të marra nga arkivi i Londrës, Berlinit dhe i Tiranës. Ka kontribuar në grumbullimin e gazetave dhe revistave të kohës, gjithashtu ka siguruar numër të madh të literaturës e cila ka pasur lidhje të drejtpërdrejt ose të terthortë me temën.

Kandidati ka vizituar Biblotekën Kombëtare të Tiranës, bibliotekën Kombëtare të Prishtinës. Duke i qëndruar besnik temës së marrë në studim kandidati ka dhënë formë dhe përmbajtje shkencore brënda suazave të shkencës së historisë.

Kandidati ka paraqitur edhe lidhjet e kohës të përkrahësve të Zogut me shtetet fqinje, Myfit Libohova kishte lidhje me shtetin grek, Shefqet Verlaci kishte lidhje me shtetin italian kurse vetë Zogu dhe Kryeziu kishte lidhje me Jugosllavinë gjegjësisht Serbinë. Ikja e tyre trgopte se me cilat shtete kishin mardhënie.

Të gjeturat sipas arkivave dhe gazetave të kohës shfaqin në shesh politikën liberale që përpiket ta ndiqte Noli, poashtu del në shesh përpjekja e Nolit për zhvillimin e pluralizmit në Shqipëri. Gazeta gjermane sidomos ato që ishin ma liberale e paraqisnin në artikuj të ndryshëm veprimtarinë e qeverisë së Nolit.

Kontributi i kandidatit rreth temës në fjalë është i qartë sepse me muaj të tërë ka hulumtuar në arkivat e Gjermanisë, po ashtu ka arritur të nxjerrë materiale nga Arkivi Nacional i Londrës. Në arkivin qendror shtetëror të shtetit shqiptarë ka hulumtuar rreth dy vite duke nxjerrë dokumente me rëndësi për temën. Në arkivin qendror të shtetit shqiptarë kam arritur të nxjerrë dokumente të zyreve sekrete të shtetit shqiptarë të cilat i dërgoheshin ministrisë së punëve të brendshme, në ato dokumente paraqitej veprimtaria e fshehtë e oficerave myfidista të ciët punonin në sabotimin e qeverisë së Nolit dhe pregaditjen e kthimit të Zogut në pushtet, me zgjedhje nëse do të mbaheshin por edhe me luftë.

Gjithashtu autori ka arritur të nxjerrë material konfidencial nga Arkivi Nacional i Londrës ku paraqitet mosinformimi i qarqeve britanike rreth revolucionit të qershorit të vitit 1924, gjithashtu nga Arkivi Nacional i Londrës kam arritur të gjejë të dhëna për interesimin e qeverisë britanike për intervenimin ushtarak të jugosllavisë ku paraqiten detajet e përgaditjeve ushtarake për ta sulmuar qeverinë e Nolit, si dhe interesimin britanik për Ceno Kryeziun.

Kandidati ka arritur të siguroi materiale arkivore rreth mospranimit të zbatimit të urdhërave për konfiskim të pasurive të përkrahësve të Zogut nga përfaqësuesit e shoqërië Ora e Maleve që ishte pjesë e qeverisë. Si dhe ka arritur të siguroi material arkivor rreth shoqërisë liberale e cila vepronte kryesisht në Shqipërinë e Jugut dhe kishte për qëllim shkatërrimin e shoqërisë Bashkimi, qëllimi ishte moszbatimi i planit të konfiskimit të pasurive të përkrahësve të Zogut.

Shoqëria Liberale maskohej sipas shërbimeve sekrete të kohës kinse përkrahëse e parimeve liberale për të cilat punonte Noli. Veprimtarinë kundër qeverisë së Nolit përkrahësit e Zogut e kishin rritur kur Noli ishte në sesionin e pestë të Lidhjes së Kombeve në Gjenevë të Zvicrës gjatë muajve Gusht dhe Shtator.

Në këtë punim disertacioni është paraqitur sulmi i vazhdueshëm i bandave serbe në territoret shqiptare me ndihmën e Ceno Kryeziut dhe bashkpuntorëve që gjendeshin në brendësi të Shqipërisë. Diplomacia jugosllave kishte punuar mjaft shumë që ta paraqiste qeverinë e Nolit si bolshevike, ajo ishte ankuar para shumë qarqeve diplomatike se Noli kishte Lidhej me bolshevikët dhe se një qeveri e tillë ishte rrezik për Evropën, për fat të keq kishte arritur ti bindte disa qeveri, kjo bëhej për ta arsyetuar intervenimin ushtarak që pritej tëndodhte. Duke parë situatën e rëndë ekonomike, politike por edhe sociale si dhe rrezikun e intervenimit ushtarak nga jashtë një grup oficerësh ishin përpjekur që ta krijonin një qeveri gjithpërfshirëse por nuk kishin pasur sukses.

Fusha shkencore në të cilën aplikohet ky punim disertacioni

Ky punim disertacioni do të aplikohet në Historin Bashkohore Shqipëtare, mund të aplikohet edhe në shkencat tjera sociale, në shkencat ushtarake, letrare, gazetaria etj e tërë kjo sepse zhvillimet kanë qenë revolucionare dhe brenda një periudhe gjashtë mujore janë zhvilluar shumë veprimtari.

Në historinë bashkëkohore shqiptare ky punim sqaron shumë të pa thëna dhe e ndihmon historiografinë bashkohore shqiptare dhe botërore të nxjerrë të vërtetën shkencore të Revolucionit të qershorit 1924 të udhëhequr nga përfaqësuesi i Federatës Panshqiptare Vatra Fan.S.Noli i cili me ndihmën e organizatave dhe patriotëve të tjerë e merr pushtetin në Shqipëri dhe qeverisë për gjashtë muaj duke u përballë me armiq që kishin shumfish forcë ma të madhe, dhe kishin gjetur përkrahës brenda vendit për ti arritur qëllimet e veta eksplatuase.

Hulumtime të mundshme në të ardhmen

Tema e marrë në studim **Roli i “Vatrës”, dhe përfaqësuesit të saj Fan.S.Noli në revolucionin e qershorit dhe qeverisjen gjashtë mujore të vitit 1924** hap shtigje shkencore për shumë tema, vetë tema ka lidhje të shumta me ngjarje historike që kanë nevojë për elaborim të mëtutjeshëm.

Sa ma shumë të merresh me studimin e “Vatrës”, aq ma shumë sheh historinë e vërtetë të popullit shqiptarë kudo. Gjendja e Federatës Panshqiptare “Vatra”, që nga largimi i Nolit prej saj. Kjo temë për shkak të përmasave që ka mund të hulumtohet ende në arkivat e Uashingtonit në kishat e Bostonit, në Austri ku Noli kishte formuar organizatën KONARE, në Itali ku ishte larguar nga Shqipëria etj.

Federata Panshqiptare Vatra ka dhënë kontribut të madh për popullin shqiptarë prej formimit të saj, gjatë historisë sa here është rrezikuar çështja kombëtare ka reaguuar Federata Panshqiptare “Vatra”, duke i dalë në ndihmë popullit shqiptar, ajo është aktive dhe sot, studimi I historikut të saj është një kontribut i çmuar për historiografinë shqiptare.

Vlerësim dhe rekomandim

Nisur nga vlerësimet e sipërthëna Komisioni shkencor për vlerësimin e dorëshkrimit të temës së doktoraturë **“Roli i “Vatrës”, dhe përfaqësuesit të saj Fan.S.Noli në revolucionin e qershorit dhe qeverisjen gjashtë mujore të vitit 1924”** të kandidatit **Mr. Naim Seferi**, në përbërje të mëposhtme, ka nderin që ti propozoj Këshillit Mësimor –Shkencor të Fakultetit Filozofik miratimin e këtij raporti dhe të krijoj kushte për mbrojtjen publike të këtij disertacioni të doktoraturës.

Komisioni recenzues:

1. Prof. Dr. Fehari Ramadani (Kryetar)

2. Prof. Dr. Zeqirja Idrizi (anëtar)

3. Prof. Dr. Zeqirja Rexhepi (anëtar)

4. Prof. Dr. Nuri Bexheti (anëtar)

5. Prof. Dr. Qani Nesimi (Mentor)

Tetovë, 28.09.2020.